



RAPORT STATISTIKOR
JANAR - PRILL 2023



Hyrje

Raporti synon të japë një përshkrim analitik të treguesve të primeve të shkruara bruto dhe dëmeve të paguara të Tregut të sigurimeve dhe me pas të shoqërisë Insig sh.a për periudhën janar-prill 2023, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, si edhe për tregues specifikë të dhënat krahasohen për periudhën janar-prill të viteve nga 2019-2023. Në përfundim të raportit ndërtohen projeksione dhe jepen vlerësime të mbështetura në fakte dhe gjykime.

Burimet kryesore mbi të cilat mbështetet raporti janë; Buletini Statistikor zyrtar i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për periudhën janar-prill 2023 dhe të dhënat statistikore të përpunuara për periudhën në shqyrtim, të shoqërisë Insig Sh.a

Tabela e përmbajtjes

1. Tregu i sigurimeve gjatë periudhës Janar- Prill 2023.....	2
1.1 Primet e shkruara bruto nga aktiviteti i Jo Jetës	3
1.2 Dëmet e paguara nga aktiviteti i Jo Jetës	4
2. Prime të shkruara bruto nga shoqëria Insig për periudhën Janar-Prill 2023.....	5
2.1 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimit të aksidenteve	6
2.2 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimeve Motorike	7
2.3 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimit të pronës	8
2.4 Primet e shkruara bruto për klasat e tjera	8
3. Dëmet e paguara nga shoqëria Insig për periudhën Janar-Prill 2023.....	9
3.1 Dëmet e paguara nga sigurimet motorike	9
3.2 Dëmet e paguar nga sigurimet e Pronës dhe Aksidenteve e Shëndetit	10


1. Tregu i sigurimeve gjatë periudhës Janar-Prill 2023

Tregu i sigurimeve për periudhën janar-prill 2023 ka realizuar 6,819,322 mijë lekë prime të shkruara bruto nga tregu i sigurimit të Jetës, Jo Jetës dhe veprimtaria e risigurimeve duke shënuar rritje me 16.75% krahasuar me periudhën janar-prill 2022. Nga aktiviteti i Jo Jetës janë realizuar 6,251,248 mijë lekë prime duke shënuar një rritje me 16.17% dhe nga aktiviteti i Jetës janë realizuar 566,649 mijë lekë prime duke shënuar një rritje prej 23.82%, kurse veprimtaria e risigurimeve ka realizuar 1,425 mijë lekë duke shënuar një rënie me 42.94%. Vlera e dëmeve të paguara nga industria e sigurimeve është 2,107,611 mijë lekë me një rënie prej 3.26% krahasuar me periudhën janar-prill të vitit 2022. Njësoj si treguesit e primeve të shkruara, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara afro 92.10% e tyre paguhet nga aktiviteti i Jo Jetës, 3.83% e tyre nga aktiviteti i Jetës dhe 4.07% nga dëmet e paguara të fondit të kompensimit.

1.1 Primet e shkruara bruto nga aktiviteti i Jo Jetës


Totali i primeve të shkruara bruto nga aktiviteti i Jo Jetës është 6,251,248 mijë lekë duke shënuar rritje me 16.17% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022. Ndikimin kryesor në rezultatin e rritjes së përgjithshme të tregut e japin sigurimet e detyrueshme motorike me 9.38% rritje, dhe sigurimet e përgjegjësisë me 66.83%, kredit e garancite me 51.64% e me radhe. Ndikimi i tyre i rëndësishëm vjen nga përpjesa që ata kanë në totalin e tregut grafiku1.

Grafiku 1: Ndryshimi i primeve të shkruara bruto sipas klasave të sigurimit, janar-prill 2023/2022




Duke ju referuar periudhës janar-prill për vitet 2019-2023 sipas grafikut 2, trendi i primeve rezulton me një rënie në vitin 2020 ku shënon dhe vlerën më të ulët dhe fillon grihet gradualisht duke shënuar vlerën më të lartë në janar-prill 2023.

Grafiku 2: Ecuria e primeve të shkruara bruto tregu i sigurimeve, janar-prill 2019-2023 (mijë lekë)




Tregu vazhdon të dominohet nga klasa e sigurimeve të detyrueshme motorike duke zotëruar 28.16% të totalit të primeve të shkruara bruto, e ndjekur më pas nga sigurimet e pronës me 18.12% ndërsa pjesa tjetër e ndarë midis klasave të tjera. Referuar grafikut 3, ku paraqitet raporti i sigurimeve vullnetare me ato të detyrueshme për periudhën janar-prill përpjesa që sigurimet vullnetare zënë ndaj sigurimeve totale është më e madhe në periudhën janar-prill të vitit 2023 me 41.84% prime vullnetare ndaj totalit. Ndërkohë që raporti më i ulët paraqitet në periudhën janar-prill të vitit 2019 me 35.75%. Për periudhën raportuese raporti rezulton 41.84% me 58.16%.

Grafiku 3: Raporti vullnetare/totalit për periudhën janar-prill 2019-2023 (mijë lekë)




Referuar sigurimeve të detyrueshme motorike, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë rezultojnë të gjitha me rritje, TPL me (+8.75%), kufitare me (+8.17%), dhe kartoni jeshil me (+10.84%). Numri i kontratave të lidhura për sigurimet e Jo Jetës gjatë muajve janar-prill 2023 është 343,329 kontrata, duke shënuar rritje prej 16.06% ose 47,516 kontrata më shumë se një vit. Klasa e sigurimeve motorike vullnetare rezulton me rënie të numrit të kontratave prej -0.60%, aksidentet dhe shëndeti me -4.02% dhe marinë, aviacion dhe transport t -5.55%, ndërsa pjesa tjetër shënon rritje, ku rritjen më të madhe e mban klasa e sigurimeve të kreditit dhe garancive. Norma e rritjes së tregut është rreth 16.17% krahasuar me janar-prill 2022,

Grafiku 4: Norma e rritjes së primit, janar-prill 2023/2022




Grafiku 5: Raporti vullnetare/totalit, janar-prill 2023



1.2 Dëmet e paguara nga aktiviteti i Jo Jetës


Gjatë periudhës janar-prill 2023 nga aktiviteti i sigurimit të Jo Jetës janë paguar 1,941,048 mijë lekë dëme, duke shënuar një rënie me 1.94% ose 38,388 mijë lekë pagesa më pak krahasuar me periudhën janar-prill të vitit 2022 dhe kjo shoqërohet edhe me rënien e numrit të rasteve të paguara prej 0.78% ose 141 raste me pak.

Grafiku 6: Ecuria e dëmeve të paguara nga tregu (mijë lekë), janar-prill 2019-2023



Sipas grafikut 6, vlera më e lartë e dëmeve të paguara është në muajt janar-prill të vitit 2020 (rastet e temeteve), për gjithë periudhën e viteve 2019-2023. Grafikun 7, ndryshimi i dëmeve të paguara sipas klasave.

Grafiku 7: Ndryshimi në dëmet e paguara sipas klasave të sigurimeve, janar-prill 2023/2022¹




Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara vjen nga lloji i sigurimeve motorike rreth 79.00% e totalit, ndjekur nga aksidentet dhe shëndeti me 10.13%, prona me 7.89% dhe të tjera me 2.97%.

2. Prime të shkruara bruto nga shoqëria Insig për periudhën Janar-Prill 2023

Aktiviteti i shoqërisë INSIG për periudhën janar-prill 2023 për Tregun e Sigurimeve të Jo Jetës, u mbyll me një rezultat primesh të shkruar bruto prej 398,217 mijë lekë, **duke shënuar një rritje prej 9.85%** ose 35,699 mijë lekë më shumë krahasuar me periudhën janar-prill të vitit 2022. Krahasuar me janar-prill nga vitet 2019 – 2023, ecuria e primeve të shoqërisë Insig është pothuajse jo e rregullt, duke shënuar vlerën më të ulët në janar-prill të 2020-ës dhe vlerën më të lartë të primeve të realizuara në janar-prill të vitit 2023 paraqitur grafikisht si më poshtë në grafikun 8.


Grafiku 8: Ecuria e primeve të shkruara bruto Insig, janar-prill 2019-2023 në mijë lekë



Raporti i sigurimeve vullnetare ndaj totalit për periudhën janar-prill të vitit 2023 është 18.03% me 81.97%, duke pasur një rritje të këtij raporti krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022,

ku raporti i vullnetareve ndaj totalit ishte 17.79% . Ecuria e këtij raporti për periudhën janar-prill nga 2019-2023 paraqitet sipas grafikut 9 .


Grafiku 9: Prime vullnetare ndaj totalit Insig, janar-prill 2019-2023 (mijë lekë)



2.1 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimit të Aksidenteve e Shëndetit

Gjatë periudhës janar-prill të vitit 2023 nga klasa e sigurimit të Aksidenteve dhe Shëndetit janë realizuar 6,623 mijë lekë prime të shkruara bruto duke shënuar një rritje me 27.34% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022. Kjo rritje është shoqëruar me rritjen e numrit të kontratave prej 1.64%. Primet e realizuara nga ky grup në raport me totalin janë 1.66% e tyre. Grafiku 10, ilustron ecurinë e primeve të shkruara bruto për periudhën janar-prill nga vitit 2019–2023. Vlera më e ulët e primeve të grumbulluara shënohet për periudhën janar-prill të vitit 2021, ndërsa më e larta për periudhën janar-prill 2019.

Grafiku 10: Primet e shkruara bruto klasa e aksidenteve e shëndetit Insig, janar-prill 2019-2023 (mijë lekë)




2.2 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimeve Motorike

Në klasën e sigurimeve motorike, përfshihen sigurimet e detyrueshme motorike TPL, Karton Jeshil, Kufitare dhe sigurimet vullnetare motorike, Kasko. Nga klasa e sigurimeve motorike shoqëria Insig për periudhën janar-prill të vitit 2023 ka grumbulluar 344,708 mijë lekë prime të shkruara bruto, duke shënuar rritje me 9.13% e cila u shoqërua edhe me rritjen e numrit të


kontratave me 24.76% krahasuar me periudhën janar-prill të vitit 2022. Vetëm nga sigurimet e detyrueshme motorike primet e shkruara bruto janë 326,404 mijë lekë, të cilat përbëjnë rreth 94.69% të gjithë primeve të klasës motorike. Nga sigurimet e detyrueshme motorike TPL zë pjesën më të madhe krahasuar me 2022 dhe ka një rritje 9.13%, Kartoni Jeshil ka një rritje me 11.75% dhe Kufitare ka një rritje me 8.32%. Ndërkohë për periudhën janar-prill 2023, primet e shkruara bruto për sigurimin Kasko janë 18,304 mijë lekë, duke shënuar një rritje me 2.61% krahasuar me vitin 2022. Primet e kësaj klase zënë 5.31% të totalit të motorikeve. Primet e realizuara nga sigurimet motorike, bëjnë pjesën më të madhe të totalit të primeve të INSIG, duke zënë respektivisht 86.56% të tij. Grafiku 11, ecuria e primeve për janar-prill nga 2019–2023, ku vlera më e ulët shënohet për janar-prill e vitit 2020 dhe vlera më e lartë në janar-prill e vitit 2023.

Grafiku 31: Ecuria e primeve - klasa e sigurimeve motorike të detyrueshme Insig, janar-prill 2019 - 2023 (mijë lekë)



Trendi i primeve të realizuara për sigurimet Kasko, është i luhatshëm duke parë ecurinë për periudhën janar-prill nga 2019 -2023, ku vlera më e ulët shënohet në vitin 2020 dhe vlera më e lartë në vitin 2021, sipas grafikut 12.

Grafiku 42:: Ecuria e primeve Insig – klasa e sigurimeve kasko, janar-prill 2019-2023 (mijë lekë)




2.3 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimit të pronës

Në klasën e sigurimeve të pronës sipas të dhënave të AMF-së, përfshihen përveç sigurimeve nga Zjarri, Forcat e Natyrës dhe Dëmtime të tjera në Pronë edhe sigurimet e punimeve në ndërtim si CAR apo dhe EAR. Totali i primeve të realizuara nga kjo klasë për periudhën

janar-prill të vitit 2023 është 19,613 mijë lekë, duke shënuar rritje me 6.18 % e cila u shoqërua edhe me rënien e numrit të kontratave me 21.90% krahasuar me janar-prill të vitit 2022. Në raport me totalin e primeve të INSIG për periudhën janar-prill të vitit 2023, kjo klasë realizon 4.93% të primeve totale të vetë shoqërisë. Ecuria e primeve bruto të kësaj klase për periudhën janar-prill nga 2019-2023 paraqitet në grafikun 13 , ku vlera më e ulët i takon vitit 2019 dhe vlera më e lartë arrihet në vitin 2021.


Grafiku 53: Ecuria e primeve Insig - klasa e sigurimeve të pronës, janar-prill 2019-2023 (mijë lekë)



2.4 Primet e shkruara bruto për klasat e tjera

Në klasat e sigurimeve të tjera përfshihen llojet e sigurimeve të Garancive, Mallrave në Transport, Përgjegjësi, Aviacionit dhe Marinës. Në raport me totalin e primeve të realizuara për periudhën janar-prill të vitit 2023, ky grup realizon 6.85% të totalit. Sigurimi i përgjegjësi zë peshën më të madhe në këtë grup, i ndjekur nga sigurimet e garancive dhe me pas klasat e tjera të sigurimeve sipas grafikut 14.

Grafiku 64: Ecuria e primeve Insig për klasat e tjera, janar-prill 2019-2023 (mijë lekë)




Klasa te Tjera,	2019	2020	2021	2022	2023
Sigurimi i garancive	5,301	5,473	7,401	6,176	4,137
Sigurimi mall në transport	22	0	0	56	0
Sigurimi i përgjegjësi	3,525	11,200	16,810	16,105	22,495
Sigurimi i avacionit	9,592	0	0	0	0
Sigurimi i marinës	1,841	57	637	627	641

3.Dëmet e paguara nga Insig për periudhën Janar-Prill 2023


Për periudhën janar-prill 2023 totali i dëmeve të paguara nga shoqëria INSIG është 160,471 mijë lekë pagesa duke shënuar një rritje me 82,27%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022. INSIG renditet në vend të gjashtë në treg duke paguar rreth 8.27% të totalit të dëmeve. Ndërkohë numri i dëmeve të paguara është rritur me **32.20%** ose 151 raste më shumë krahasuar me periudhën janar-prill të vitit 2022. Raporti dëme/prime për periudhën janar-prill 2023 rezulton të jetë 40.30%. Për INSIG, pjesa më e madhe e vlerës së pagesave për muajin janar-prill 2023 i takon sigurimeve motorike që zënë 74.29% të totalit të pagesave, e ndjekur nga sigurimet e garancive me 21.76%, zjarri me 3.60% dhe aksidentet me 0.35%. Më poshtë grafiku 15, paraqitja grafike e peshës specifike të pagesave që zë secila klase ndaj totalit, për periudhën janar-prill 2023.

Grafiku 15: Pjesa e dëmeve të paguara nga llojet e sigurimit Insig, janar-prill 2023



Duke ju referuar ecurisë së pagesave në vite vihet re që, për periudhën janar-prill nga viti 2019-2023, kemi një luhatje pagesash. Janar-prill i vitit 2023, shënon vlerën më të lartë të pagesave dhe viti 2019 shënon vlerën më të ulët. Raporti dëme/prime është më i lartë në vitin 2023 rreth 40.30% sipas grafikut 16.

Grafiku 16: Ecuria e dëmeve të paguara të Insig, janar-prill 2019-2023 (mijë lekë)




3.1 Dëmet e paguara nga sigurimet motorike

Sigurimeve motorrike për periudhën janar-prill 2023, kapin vleren prej 119,219 mijë lekë ose 74.29% të totalit të pagesave. Nga karahasimi me periudhën janar-prill të vitit 2022, kemi një rritje prej 49.10%. Brenda grupit 15.92% e pagesave i takon sigurimit motorik vullnetar Kasko dhe pjesa tjetër prej 84.08% i takon pagesave për sigurimet e detyrueshme motorike .Referuar karahasimit me janar-prill të vitit 2022, TPL rezulton me rritje pagesash prej 31.08%, Kartoni Jeshil rezulton me rritje prej 83.04%, Kasko rezulton me rritje prej 419.04%, ndërsa Kufitare rezulton me një rënie -89.73%.

3.2 Dëmet e paguar nga sigurimet e Pronës dhe Aksidenteve e Shëndetit

Pjesa tjetër e dëmeve të paguara vjen nga klasa e sigurit të Pronës , Garancive dhe Aksidenteve e Shëndetit. Nga klasa e sigurimeve të pronës për janar-prill 2023 vlere e dëmeve të paguara është 5,769 mijë lekë me një rënie prej 15.44% me vitin 2022 . Raporti dëme/ prime i sigurimeve të pronës është 29.55% Nga sigurimi i Garancive vlere e dëmeve të paguara për janar-prill 2023 është 34,917 mijë lekë me një rritje shumë herë më të lartë se viti 2022 . Përsa i përket Aksidenteve dhe Shëndetit për periudhën janar-prill 2023, shënohen rreth 566 mijë lekë pagesa ose 0.35% të totalit të pagesave të INSIG.Krahasuar me vitin 2022, rezulton një rënie prej 43.96%. Raporti i dëmeve të paguara ndaj primeve të realizuara për këtë klasë është 8.55%.Kjo klasë në raport me pagesat totale të tregut zë 0.29% të këtij totali. Grafiksht 17, ecuria e pagesave për periudhën janar-prill 2022-2023 dhe ndryshim në përqindje sipas klasave të sigurimeve.

Grafiku 17: Pagesat sipas klasave dhe ndryshimi në përqindje Insig, janar-prill 2022-2023 (në mijë lekë)



D.Paguara	TPL	Karton Jeshil	Kufitare	Kasko	Aksid, & Shend,	Zjarr	Garanci	Transport
2022	63,953	8,767	3,583	3,656	1,010	6,822	248	0
2023	83,828	16,047	368	18,976	566	5,769	34,917	0
Ndysh.%	31.08%	83.04%	-89.73%	419.04%	-43.96%	-15.44%	0.00%	0.00%

Burimi: AMF&INSIG